

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 10655 Rep.
Nr. 3354 Kol.

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot, me daten 21/11/2005 ne zyren e Noterise Tirane, perpara meje **Noteres Mimoza Shehu** u paraqiten personalisht te interesuarit si me poshte me cilesine e shitesit dhe bleresit te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te K.Civil si dhe te Ligjit "Per shoqerite tregtare" kerkuan redaktimin e kesaj kontrate si vijon:

SHITESI: Hajredin Ukperaj, i biri i Sulejman it, dtl. 1968, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i njohur personalisht prej meje Noteres.

DHE

BLERESI: Skender Bokciu, i biri i Rexhepit, dtl. 1967, lindur ne Has, banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga pasaporta me nr. 1871889.

OBJEKT: Transferimin e kuotave te shoqerise "ARIFAJ" shpk qe i perkasin Z. Hajredin Ukperaj ne mbeshtetje te ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" neneve 62, 63 dhe neneve te Statutit te shoqerise tregtare "ARIFAJ" shpk.

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te shoqerise "ARIFAJ" shpk, shoqeri kjo e regjistruar si person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane nr. 16891 date 3.2.1997

Ortakët e shoqerise "ARIFAJ" shpk zoterojne :

Z. Skender Bokciu me 50 % te kuotave te kapitalit.

Z. Hajredin Ukperaj me 50% te kuotave te kapitalit.

Ne mbeshtetje te Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" nenit 62, 63 dhe neneve perkates te Statutit te shoqerise tregtare "ARIFAJ" shpk shitesit dhe bleresi bien dakort midis tyre per shitjen e kuotave si me poshte vijon:

1) Shitjen e pjeseve te kapitalit te shoqerise me menyren si vijon:

Z. Hajredin Ukperaj i cili zoteron 50% te kuotave te kapitalit ia shet keto kuota Z. Skender Bokciu kundrejt shumes 25.000.000 leke i cili nga ana e tij deklaroi se eshte dakort per blerjen e tyre.

Perfundimisht ortak i vetem i shoqerise do te mbetet **Z.Skender Bokciu** i cili zoteron 100% te kuotave te kapitalit.
Nga ky moment ata marrin persiper te gjitha te drejatat dhe detyrimet qe rrjedhin nga administrimi i kesaj shoqerie.

Kontrata si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruhet vullnetarisht ne prani te noteres nga shitesi dhe bleresi dhe une noterja legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Kontrata u redaktua ne tre kopje me fuqi te barabarte secila,ku njera prej tyre arkivohet ne kete zyre noteriale.

SHITESI

BLERESI

HAJREDIN UKPERAJ



SKENDER BOKCIU

Skender Bokciu


Notere
Alimoza Shela
Tel.: (04) 232453, (04) 227125

